

PËRMBLEDHJE E MINUTAVE TË MBLEDHJES
KËSHILLI I INVESTIMEVE (KI)
MBLEDHJA XXVIII
“Mbi Disponueshmërinë dhe Aftësinë e Fuqisë Punëtore”

Tiranë, 26 tetor 2022, 14:30 – 16:00

Mbledhja u drejtua nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, znj. Delina Ibrahimaj, Kryetare e KI. Në mbledhje morën pjesë 12 anëtarë të KI dhe mbi 40 vëzhgues – përfaqësues të shoqatave të biznesit vendas dhe të huaj dhe institucioneve shtetërore në Shqipëri.

Hapja e Mbledhjes nga Ministria Delina Ibrahimaj, Kryetare e KI

Në fjalën e saj hyrëse, Ministria Ibrahimaj theksoi rëndësinë e aftësive të nevojshme sipas kërkesave dhe nevojave të biznesit, në kushtet kur tregu në vitet e fundit ka pësuar zhvillime dinamike, sidomos në drejtim të dixhitalizimit. Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka ndërmarrë disa politika në funksion të zhvillimit dhe reformimit të arsimit dhe formimit profesional në vend. Ministria theksoi faktin se aktualisht po punohet për hartimin e Strategjisë së re Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, e cila do të konsultohet me grupet e interesit para miratimit final. Një prej shtyllave kryesore të këtij dokumenti lidhet me transformimin dixhital që po pëson vendi dhe ofrimin e aftësive dixhitale që më së shumti kërkohen sot nga tregu i punës. Me mjaft rëndësi, sipas Ministres Ibrahimaj, është rritja e informimit dhe ndërgjegjësimit për programet e nxitjes së punësimit, ashtu si edhe për vendet e lira të punës, në mënyrë që të ulët hendeku mes personave të papunë apo atyre që nuk kërkojnë punë dhe kërkesave të biznesit për punonjës. Ministria u shpreh se duhet punuar më shumë për rritjen e informimit për programet e nxitjes së punësimit dhe për përfitimet që bizneset kanë me qëllim nxitjen e punësimit dhe marrjen e stafëve të reja në punë. Po ashtu, Ministria u shpreh se duhet të rritet informimi edhe sa i përket programit të Garancisë Rinore, i cili po zbatohet në bashkëpunim me BE, duke synuar rritjen e pjesëmarrjen në forcat e punës për grupmoshën 15-29 vjeç.

Prezantimi i analizës së Sekretariatit

Znj. Diana Leka (Angoni), Sekretariati i KI, falenderoi përfaqësuesit e shoqatave dhe institucionet publike për bashkëpunimin, dhe informoi se analiza e Sekretariatit ka si qëllim kryesor **prioritizimin e ndërhyrjeve**, sipas perspektivës së sipërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM) mbi alternativat e mundshme për minimizimin e efekteve të “krizës së fuqisë punëtore” duke u fokusuar në 5 shtylla:

- (1) Aksesin e biznesit në informacionin e duhur
- (2) Kulturën e punës dhe modelin për të rinjtë
- (3) Inovacionin dhe aftësitë
- (4) Ndërveprimi i harmonizuar i ekosistemit
- (5) Informaliteti në punë

Përmbledhje e diskutimeve kryesore

Z. Luan Bregasi, Business Albania, u shpreh se Këshilli Investimeve është aktualisht e vetmja platformë ku përfaqësuesit e sektorit publik dhe privat mund të debatojnë për problemet që ka sipërmarrja në vend. Për këtë arsye është e nevojshme që të rritet pesha reale e platformës, ku përveç dhomave dhe shoqatave të biznesit, të ftohen edhe kompani të fuqishme e serioze që të bëjnë propozime për të ardhmen e ekonomisë në vend. Në lidhje me temën e diskutimit, ngriti dy çështje:

1. *Nevojitet të forcohen shkollat profesionale*. Në vitin 2014, në shkollat profesionale studionin rreth 3,000 nxënës, ndërsa sot janë afërsisht 25,000. Kurrikulat e shkollave profesionale duhet t'i përputhim me nevojat që ka tregu, duke i përafuar sa më shumë me nevojat e sektorit privat.
2. Duhet të bëhet një *kontroll i personave që marrin asistencë sociale* pasi një pjesë e mirë e tyre janë të aftë për punë. Ka propozime që të penalizohen edhe personat që braktisin punën.
3. *Beteja ndaj informalitetit duhet të vazhdojë edhe në tregun e punës*. Propozohet të bëhet ndarja e rrogës bruto me atë neto.
4. *Certifikim të profesioneve të veçanta* nga Dhoma Kombëtare e Zejtarisë. MFE të ndërhyjë nëpërmjet një VKM që kjo të bëhet realitet.

Z. Edvin Preçe, Proeksport Albania, ngriti çështjet e mëposhtme:

- Libreza e punës të bëhet telematike për ta aksesuar nëpërmjet e-albania.
- Sistemi shëndetësor duhet të dixhitalizojë librezat e shëndetësisë. Lejet e lindjes nuk duhet të vazhdojnë të vulosen çdo muaj nga konsultorja e lagjes.
- Të llobohet me Ministrinë e Punëve të Jashtme që të krijohet mundësira dhe lehtësira për lejen e qëndrimit të punonjësve të huaj.
- Ka një ndryshim thelbësor me AKPA dhe bashkëpunimi me shkollat profesionale

Znj. Ekaterina Solovova, BERZH, theksoi rëndësinë e shkollave profesionale dhe ofrimit të inputit në kurrikulën mësimore nga sektori privat. Në këtë aspekt, BERZH është duke asistuar në ngritjen e Këshillit Sektorial të Aftësive, fillimisht në sektorin e turizmit, duke shpresuar që të vazhdohet me sektorët e tjerë, mandati i të cilit është tashmë i miratuar nga Ministria Ibrahimaj. Këshilli do të fokusohet në afrimin e sektorit privat me shkollat e arsimit profesional për formimin e kurrikulave dhe aftësive profesionale sipas nevojave dhe kërkesave të biznesit. Ky është një shembull i mirë i asaj që mund të arrihet në afat të shkurtër.

Gjithashtu, ajo vërejtë se në kohët e sotme të rinjtë do të ndryshojnë profesionin e tyre disa herë gjatë jetës së tyre; prandaj, të zgjedhurit të një kualifikimi apo profesioni që do të zgjatë gjatë gjithë kohës mund të jetë kthyer tashmë në diçka jashtë kohës. Prandaj në afat të gjatë, duhet t'i mësojmë fëmijëve të kenë mendësinë e të mësuarit në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë kohës, veçanërisht duke patur parasysh që jetojmë në një ekonomi të bazuar në njohuritë.

Më tej, znj. Solovova theksoi se si shumë vende të tjera, edhe Shqipëria vuan nga emigracioni neto—një proces që mund të vazhdojë në të ardhmen. Në anën tjetër, lufta në Ukrainë ka rritur emigrimin e profesionistëve të kualifikuar, veçanërisht në sektorin e IT. Në mbyllje të fjalës së saj, ajo ngriti një pyetje për të nxitur debatin: *A mundet Shqipëria të tërbejë disa prej këtyre emigrantëve të cilët mund të japin kontribut edhe në ekonominë lokale?*

Z. Emanuel Salinas, Banka Botërore, ngriti pikat e mëposhtme:

- *Edukimi fillor*. Në Shqipëri rreth 50% e nxënësve në fillore janë analfabetikë funksionalë, pra nuk janë në gjendje të kuptojnë një tekst të thjeshtë dhe 2/5 e nxënësve kanë mungesë të aftësive bazike. Kur flasim për “kualifikim të fuqisë punëtore” flasim në terma të TIVET (Technical Industrial Vocational and Entrepreneurship Training Programs) që është një fokus i rëndësishëm, por ajo që duhet të kuptojmë është se kur mungojnë të dhënat/kualifikimet

bazike atëherë gjithmonë do të jemi duke u ndeshur me problematika të tilla, të mungesës së fuqisë punëtore të kualifikuar.

- Bazuar në studime të ndryshme, vetëm 0,9% e studentëve në Shqipëri presin të punojnë në TIK në një moment në kohë. Pra vërehet një mospërputhje. Nga njëra anë Shqipëria do të zhvillohet si një ekonomi e dijes, dhe sigurisht ka potencial për të qënë e tillë, por diçka nuk përputhet me nxënësit e shkollave. Kjo tregon se duhet punuar me sistemin bazë, sistemin e shkollave fillore për të krijuar bazat e një fuqie punëtore funksionale dhe produktive. Gjithashtu, rreth 40% e produktivitetit të punonjësve në Shqipëri humbet për shkak të defiçencave në sistemin arsimor dhe shëndetsor. Është e qartë që ndreqja e sistemit arsimor dhe shëndetësor do kohën e vet, por e rëndësishme është të fillohet.
- Ndërkohë mendoj se ka shumë gjëra të tjera që mund të bëhen paralelisht. Për momentin po diskutohet për stokun e të punësuarve, atyre që janë tashmë në tregun e punës dhe mospërputhjes mes kërkesës dhe ofertës për punë. Është interesant fakti që jo shumë kompani i drejtohen zyrave të punës për zgjidhjen e problematikës së përputhjes dhe këtu del që vërtet ka diçka që mund të bëhet. Në shumë vende kjo përputhje mes kërkesës dhe ofertës për punë bëhet nga sektori privat, pra nuk ka implikime nga buxheti i shtetit, dhe rezulton të jetë shumë efektive në krijimin e lidhjeve mes punëkërkuarës dhe punëmarrësit.
- Ka akoma për të bërë në drejtim të rëndësise së TIVET. Mund të bëhen analiza të tregut për të parë se cilat janë nevojat aktuale dhe të ardhme për kualifikime (skills). Disa vende kanë punuar edhe me platforma të tilla si p.sh. LinkedIn ku janë marrë databazat dhe janë identifikuar kërkesat e tregut të cilat më vonë janë implementuar në TIVET, në kurrikula, kualifikime, etj. Diçka e ngjashme mund të bëhet edhe këtu për të mundësuar fuqizimin e mekanizmit, për të kuptuar kërkesat e tregut, si edhe përpjekjet që duhen bërë për t'ia arritur kësaj. Banka Botërore do të ishte e gatshme të punojmë me qeverinë për përmirësimin e kësaj situate.

Ministër Delina Ibrahimaj, MFE, iu përgjigjet shkurtimisht komenteve të ngritura deri tani.

- U përmend nga të gjithë nevoja e përputhjes së kërkesës me ofertën për punë. Do të doja që kjo të mos ngelej këtu si bisedë me fjalën duhet, por ne të kishim një plan pune të përbashkët për mënyrën sesi t'i përafrojmë këto. Që nga dita e parë e marrjes së detyrës si Ministër i Financave kjo ka qenë problematika kryesore që kam diskutuar me drejtorinë përkatëse në ministri duke ngritur çështjen e domosdoshmërisë së informacionit më të përditësuar dhe më të shpejtë në kohë përse i përket kërkesave të tregut të punës në ditët e sotme. Kemi zhvilluar diskutime edhe me kompani ndërmjetësuese, edhe me biznese private për krijimin e një ëbsite të përbashkët ku të gjithë të hedhim të dhënat dhe të paktën kërkesa dhe oferta e punës të jenë minimumi në një sistem. AKPA po punon për krijimin e një observatori ku do të mundësohet jo vetëm marrja e statistikave, por edhe vetë kompanitë ndërmjetësuese të jenë pjesë e platformës puna.gov.al ku secili mund të vendosë njoftimet përkatëse.
- Përse i përket propozimit të përfaqësuesit të Bankës Botërore, ne jemi duke punuar në këtë drejtim. Po krijohet një "webscrap", nëpërmjet të cilit të merret jo vetëm informacioni i hedhur nga ne në lidhje me kërkesat për punë, por edhe nga sisteme të tjera si LinkedIn apo platforma të tjera të ngjashme për të mundësuar identifikimin e aftësive të kërkuara në tregun e punës në Shqipëri, por edhe më gjerë. Përse i përket kurrikulave, mendoj që vetëm pas krijimit të kesaj platforme ne do të jemi në gjendje të kuptojmë se cilat janë ato profesione, edhe të rajonalizuara, më të kërkuara në tregun e punës. Jemi munduar të bëjmë takime me biznese në secilin prej qyteteve ku ka një shkollë profesionale për të mundësuar krijimin e kurrikulave bazuar në kërkesat e vetë bizneseve. Fakt është që edhe pse që nga 2014 është rritur shumë numri i të regjistruarve në arsimin profesional, mbetemi ende ndjeshëm nën mesataren e BE përse i përket arsimin profesional. Në ditët e sotme, sidomos në sektorin privat, është evident fakti që më shumë se diploma të universiteteve apo mastera, kërkohen aftësi teknike.

- Që nga fillimi i këtij viti kemi filluar të punojmë me *personat e regjistruar në ndihmë ekonomike*, duke u ofruar atyre një alternativë formimi apo punësimi dhe deri tani 2,500 persona janë ndihmuar dhe janë pjesë e këtij programi të zbatuar në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Ky program do të vazhdojë pasi nëse ne minimizojmë numrin e personave me ndihmë ekonomike, ne do të mund të trajtojmë më mirë ata që do të mbeten në këtë program, por do t'u kemi ofruar një jetë më të denjë atyre që janë të mundshëm për t'u punësuar.
- *Informaliteti, vazhdon të jetë një sfidë shumë e madhe për ekonominë tonë.* Ne kemi punuar shumë në këtë drejtim, edhe pse në tre vitet e fundit fokusi është zhvendosur pak nga informaliteti për shkak të goditjes së vazhdueshme nga kriza të ndryshme dhe fokusi ka qënë jo shumë kontrolli tatimor, por lehtësimi i bizneseve. Një nga aktivitetet në fillim të këtij viti ka qënë aksioni i informalitetit i përqendruar tek pagat dhe punësimi i cili dha rezultatet e tij. Vetëm në harkun kohor të tre muajve në mundëm të ulim me 52% numrin e pozicioneve të punëve me pagë minimale. Kjo është shumë domethënëse duke qënë se erdhi jo nga dëshira e punëdhënësve/punëmarrësve për të deklaruar realitetin, por erdhi si rezultat i presionit të shtuar nga ana e shtetit. Ka ardhur koha që kjo nuk duhet të jetë më kështu. Sot, edhe *në sektorin fason, ka pak pozicione pune me pagë minimale.* Kjo ka ardhur jo nga dëshira e bizneseve për të rritur pagat, edhe pse ka plot biznese të tilla me përgjegjshmëri sociale. Mendoj se kryesisht ka ardhur nga fakti që nuk ka më ofertë punë për pozicione kaq pak të paguar, pra *është kërkesë-oferta ajo që përcakton cmimin*, pagën dhe punonjësit e marrin një pagë të lartë edhe pse jo të deklaruar. *Nëse me një aksion ne arritëm të ulim 52% të numrit të pozicioneve të punës me pagë minimale kjo do të thotë se ka ende gjëra që ne mund të bëjmë.* Të tjera shifra që mund t'u përmend janë: 31% e pozicioneve deklaruan rritje të pagave të tyre dhe 58% e tatimpaguesve kanë reaguuar me rritje të fondit total të pagave. Ne jemi të vendosur që të vazhdojmë me këto aksione, pasi ndryshe nga informaliteti total që dëmton konkurrencën e lirë, të ardhurat e buxhetit apo të tjera, mosdeklarimi i pagës reale dëmton më së shumti punëmarrësin i cili në të ardhmen nuk do të ketë mundësi të përfitojë një pension i cili i takon për kontributin e dhënë në atë punë dhe në shoqëri. *DPT dhe Inspektoriati i punës kanë programe të cilat adresojnë pikërisht këto problematika.* Në paketën fiskale të këtij viti ne kemi dyfishuar penaltitetet për mosdeklarimin e pagës reale dhe punonjësve në përgjithësi, sepse besojmë se kjo është një nga ato fusha ku duhet punuar më shumë në drejtim të reduktimit të informalitetit.
- *Përsa i përket propozimit ku barra e sigurimeve shoqërore t'i mbetet vetëm punëdhënësit*, ka shumë raste në botë që është kështu. Duke qënë se *de-facto* është punëdhënësi ai që e paguan, ne mund ta shohim këtë në vitin e ardhshëm dhe ta adresojmë me ndryshimet ligjore përkatëse nëse ju mendoni se është i pranueshëm. Gjithashtu do të doja që ju të bini të gjithë dakort për këtë pasi nuk dua që në konsultimet publike më pas të dalë sikur qeveria po vepron kështu pasi do të dëmtojë biznesit, gjithsesi kjo mund të diskutohet në mbledhje teknike.
- *Përsa i përket lejeve të punës*, Ministrja u shpreh se do të konsultohet me AKSHI-n për të mundësuar lejet elektronike të punës. Përsa i përket lejës së lindjeve, tashmë ISSH nuk kërkon më librezën fizike por mjaftohet me atë elektronike dhe besoj se kjo është tashmë një pikë e tejkaluar.
- *Përsa i përket punonjësve të huaj*, kemi punuar gjatë vitit të fundit përsa i përket lejeve të punës në kuadër të Open Ballkan dhe po finalizohet i gjithë sistemi dhe procedurat dhe është një treg i madh ku mund të tërhiqen punonjës. Gjithsesi edhe propozimi juaj do të diskutohet edhe me Ministrinë e Jashtme, që të paktën për sezonin turistik ku kërkesa për punonjës është më e lartë, të ketë një lloj marrëveshje me shtetet që ju sugjeroni.
- *Përsa i përket informimit*, mendoj se duhet të kemi një informim më të mirë dhe AKPA po punon fort në drejtim të komunikimit publik dhe informacionit, por mbase mbase duhet një strategji më gjithëpërfshirëse ku të gjithë aktorët/donatorët që punojnë në këtë drejtim të bashkohen

me një strategji komunikimi të përbashkët duke qënë se ka hapësira të cilat mbeten ende për t'u mbushur.

- *Përsa i përket shfrytëzimit të imigracionit*, me GIZ jemi duke punuar në lidhje me nxitjen e punësimit dhe ri-integrimit në punë të imigrantëve, edhe pse mendoj se ne duhet të bëjmë më shumë dhe komunikimi është kyç sidomos për reduktimin e dëshirës për emigracion duke bërë më të qartë të gjithë ofertën që vendi (shteti/privati/fondet e huaja) ka në lidhje me tregun e punës në mënyrë që ata që ikin ta dinë ca i pret aty ku shkojnë dhe çfarë alternativash kanë në vendin e tyre. Një nga instrumentat që mbështet këtë element është edhe garancia sovrane.

Z. Alessandro D'Oria, FIAA, ngriti çështjet e mëposhtme:

- Problematika e aftësive është një çështje globale, komplekse që nuk mund të zgjidhet lehtë. Ndërsa, mbetet edhe një problematikë specifike e cila diskutohet çdo ditë me kompanitë e prodhimit (si klientët tanë në sektorin bankar), por edhe ndërmjet aktorëve në sektorin bankar. Në një anketë të brendshme të FIAA-s mbi këtë temë me të rinjtë deri në 30 vjeç dolën në pah dy gjetje mbi interesat e të rinjve: mundësia e të mësuarit dhe paga. Sigurisht kostoja e pagës lidhet me konkurrencën e kompanive. Për të trajtuar këtë çështje, aktualisht po mendojmë të bashkëpunojmë më mirë mes nesh/kompanive dhe gjithashtu të krijojmë bashkëpunim me universitetet.
- Ndërkohë, nevojitet të rishqyrtohet mënyra se si t'i qasim pritshmëritë e brezit të ri. Për të ndihmuar më mirë kompanitë në trajtimin e çështjes së aftësive të punës dhe për të përballuar më mirë këtë çështje, kur i anketojmë të rinjtë, mund të na duhet të punojmë edhe me psikologë për të marrë parasysh jo vetëm aspektet ekonomike, por edhe aspektet socio-ekonomike.
- Në lidhje me mbështetjen e qeverisë, nevojitet që qeveria të mos përqendrojë investimet në qytetet kryesore si Tirana dhe Durrësi. Kur investohet në logjistikë dhe infrastrukturë, duhet të merren parasysh edhe stimujt si instrumente për ata që punojnë jashtë këtyre qyteteve.
- Për të rinjtë që janë të papunë dhe nuk duan të punojnë, nevojitet një analizë e kujdesshme, pasi është problem edhe në Itali.
- Ndërsa, në nivel kombëtar, nevojitet të bëhet promovimi i vendit dhe mundësive të tij tërheqëse.

Znj. Elizabeta Katiaj, Dhoma e Biznesit të Diasporës, vlerësoi punën e Sekretariatit në drejtim të evidentimit me shkrim të problematikave me një frymë gjithëpërfshirëse. Më tej, sugjeroi:

- a) *Lehtësimin e procedurave si i vetëpunësuar për të kthyerit nga diaspora*. Për shembull, krijimi i qendrave (*hub-ëve*) me mbështetje të donatorëve. Kemi modele pozitive (nga GIZ) me kontrata të financuara për një vit, ku mendojmë se afati një-vjeçar është i mjaftueshëm për të kthyerit për t'u ri-integruar në vend;
- b) *Falimenti i kompanive dhe largimet kolektive*. Të konsiderohet një procedure standarde me zyrat e punës që në rast të falimentit përpara se të shpallin largimet kolektive këto kompani të kontaktojnë zyrat e punës, që paraprakisht t'i detyrojnë/ndërmjetësojnë me kontaktimin e operatorëve që janë në treg gjë e cila mund të ndihmojë edhe në aksesin në punësim përpara largimit kolektiv.

Znj. Donada Rata, Rrjeti i Profesionistëve të Rinj (YPN), shprehu vlerësimin për dy anketimet e Sekretariatit për faktin se kemi përballe sektorin privat dhe të rinjtë, si dy nga aktorët kryesorë të sfidës që ka tregu i punës, ndaj edhe YPN kontriboi me kënaqësi në organizimin e mbledhjes fokus grup të Sekretariatit. Tek të rinjtë ka mungesë të informacionit në lidhje me tregun e punës (ofertën e tregut) dhe ata kërkojnë të aftësohen. Ka mungesë të *soft skills*, veçanërisht tek të rinjtë që vijnë nga zonat rurale, ku nevojat për trajnim janë edhe më të mëdha. Mund të përmendim edhe

eksperiencia nga rajoni, si p.sh. një platformë *e-learning* ku informacioni publikohet si nga punëdhënësit, punëmarrësit ashtu edhe nga mentorët që japin trajnime të veçanta. Nga eksperiencia me RCC, problematikat e punësimit të rinjve në Shqipëri janë të njëjta me ato të vendeve të Ballkanit. Ndërkohë për praktikatat e punës—ndonëse nuk paguhen, YPN rekomandon që të konsideroheshin pak me ndryshe nga sipërmarrësit, për shembull si forma trajnimi pasi të rinjtë kanë nevojë që të mësojnë më shumë.

Z. Luan Bregasi, Business Albania, u shpreh se në lidhje me çështjen e intershipeve, biznesi ka qenë i hapur dhe mirëpret të gjithë studentët dhe profesionistët. Biznesi ka nevojë për ta dhe kjo është mënyra më e mirë për të njohur të rinjtë se çfarë aftësish kanë. Biznes ka interes edhe për punëtorët dhe i paguan edhe periudhën 2-muajore që ata mësojnë. Pjesa dërrmuese e biznesit i mirëpret studentët dhe profesionistët për të qënë pjesë e kompanive.

Z. Gëzim Peshkopia, Shoqata e Bukës, Brumërave dhe Pastiçerive, u shpreh se padyshim tregu ka nevojë jo vetëm për studentët por edhe për shitësit, bukëpjekësit, shoferët, furnitorët, sigurisht edhe për specialistët. Këto mungesa shpresojmë të mos kthehen në krizë, sepse sektori i bukës dhe ai i pastiçerisë po vuajnë realisht këto mungesa. Janë specialistë që kërkohen në të gjithë Evropën. Vetëm në Hungari janë hapur 900 furra buke nga shqiptarët.

Ministër Delina Ibrahimaj, MFE, u shpreh se problematikat e shtruara na shqetësojnë të gjithëve dhe vihet re që ka një konkurrencë për teknikë. Falenderoi të gjitha ato biznese që janë pjesë e bordeve të shkollave profesionale, si të interesuar direkt për të marr punonjës për trajnime, intershipe, dhe japin kontribut për të nxitur trajnimin e të rinjve me aftësitë e duhura. Ekziston një program nxitje të punësimit të dedikuar për praktikatat profesionale. Në lidhje me të rinjtë, kush do të kërkojë informacion, e gjen atë. Problematika është në zonat rurale ku informacioni është më i vështirë për t'u arritur. Por të rinjtë e sotëm më aftësitë dhe mundësitë dixhitale kanë më shumë mundësi punësimi se të rinjtë e para 10 viteve.

Sigurisht që ka hapësirë për t'u bërë më shumë, për këtë arsye po përgatitet një portal unik me të gjithë informacionin e duhur. Ky informacion duhet të shpërndahet në mënyrën e duhur qoftë nga ana e biznesit qoftë dhe nga ana e Qeverisë. *Shifra e punëkërkuësve të papunë që regjistrohen tek AKPA është shumë e ulët.* Në këtë kuadër mendoj se organizata si ju duhet të luajnë një rol më aktiv në ndërgjegjësimin e të rinjve dhe regjistrimin e tyre në këto portale me qëllim që edhe individët që aplikojnë tek AKPA të kenë akses në shërbimet e saj, ndërsa bizneset të kenë mundësi të shikojnë që ka një numër të konsiderueshëm profesionistësh që kanë paraqitur kërkesë për punë dhe mund t'a përdorin bashkarisht këtë platformë.

Bashkëpunimi dhe ndarja e detyrave midis aktorëve në treg është e nevojshme për të adresuar problematikat e punësimit si edhe për të shmangur krizat e mundshme për punonjës sikurse u përmend më lartë. Tregu ka nevojë për njerëz të kualifikuar por edhe për profile teknike. Të gjithë duhet të bashkëpunojnë duke bërë detyrat edhe në sektorin e vogël që mbulon. Ndërlidhësi pastaj është MFE/Shteti – AKPA e cila duhet të rrisë komunikimin e vetë si përsa i përket punëkërkuësve ashtu edhe biznesit.

Znj. Katina Gjoni, Shkolla Profesionale “Antoni Athanas”, falenderoi për hapjen e shkollës profesionale në Sarandë, sistemin në infrastrukturë dhe bazën materiale. Numri i nxënësve në degën e hoteleri-turizmit është trefishuar edhe pse oferta për punë në këtë sektor është më e lartë se ajo e nxënësve për regjistrim. Shkollat profesionale janë çerdhja e përgatitjes së profesionistëve dhe duhet punuar në ndryshimin e imazhit të shkollave profesionale në përgjithësi.

Udhëzimi për bursat e vazave në shkollat profesionale ka qenë një incentivë e rëndësishme ashtu sikurse edhe Udhëzimi në pritje për mbulimin e transportit të nxënësve në shkollat profesionale.

Për zbatimin e kurrikulës shkollore propozoi që AKPA të mundësonte në bashkëpunim me biznesin edhe praktikën e detyruara profesionale.

Z. Martin Serreqi, FEUT, u fokusua në dy pika:

1. Referuar gjetjeve të prezantuara, për sigurimin e punonjësve përmes universiteteve u shpreh se ndër vite universitetet kanë pasur problematika në të shkuarën, por trendi ka ndryshuar për mirë dhe shpresojmë që të vazhdojë në të ardhmen.
2. Referuar gjetjes mbi nevojën e adoptimit të kurrikulave me nevojat e tregut, bashkëpunimi mes dy palëve ka ekzistuar prej shumë kohësh por që të ketë rezultat pozitiv, duhet komunikim i vazhdueshëm dhe kjo duhet bërë me të gjithë universitetet dhe referuar sektorëve specifikë. Ka një ndryshim në qasjen e të rinjve të sotëm, ndaj dhe universitetet e bizneset, duhet t'i përshtatemi ndryshimeve të kohës.

Z. Elvis Ponari, Shoqata e Siguruesve të Jetës, Pensioneve dhe Fondeve të Investimit, u shpreh se punonjësit duan rrogë sot dhe kursime për të ardhmen. Incentivat që i mbajnë punonjësit të kënaqur, duhet të rishikohen në mënyrë që ato të mos largohen. Të edukohen për kalimin e një pjese të të ardhurave të tyre në formën e pensioneve private që të jenë të kënaqur.

Znj. Valbona Begolli, Dhoma Ekonomike e Gruas, u shpreh se nevojitet:

- *Zhvillimi i mendësisë të sipërmarrësve së NMVM-ve dhe sipërmarrjeve të reja* ku dhomat mund të luajnë një rol të rëndësishëm në këtë drejtim. Duhet të krijohen programe nga shteti në këtë drejtim.
- *Zhvillimi i arsimit profesional*. Në bashkëpunim me SwissContact gjatë këtyre dy viteve kemi punuar që të promovojmë sipërmarrjen në biznes që të rinjtë të shohin modele të ndryshme sipërmarrjesh, pasi nëse edukojmë të rinjtë në këtë drejtim do fillojë patjetër të ndryshojë edhe mentaliteti në tërësi ndaj sipërmarrjes dhe të mundësohet një siguri më e madhe ekonomike dhe sociale. Patjetër që teknologjia dhe inovacioni janë dy faktorë shumë të rëndësishëm që do na ndihmojnë që të jemi konkurrenca në treg dhe të përballim sfidat aktuale.

Ministër Delina Ibrahimaj, MFE, u shpreh se përmes dhomave të tregtisë ndarja e informacionit realizohet më mirë. Aktualisht, kemi programe të ndryshme zhvillimi për NMVM-të mbi aftësitë menaxheriale, hartimin e planeve të biznesit, si të bëhen administratorë më të mirë, etj., ndaj nuk mungon informacioni por dëshira e sipërmarrësve për të marrë pjesë. Është një mentalitet që duhet të ndryshojë. Anketa tregoi që 46% e bizneseve nuk kishin buxhet dhe nuk kërkojnë të trajnojnë. Qeveri aktualisht ka dhënë grante për rritjen e sipërmarrësve dhe aktualisht po jepen grante për zhvillimin teknologjik e dixhitalizimin e tyre—informacion i cili duhet të shpërndahet kryesisht përmes dhomave.

Znj. Ines Muçostepa, UCCIAL, theksoi rëndësinë e gjithëpërfshirjes së aktorëve, biznesit, akademisë dhe donatorëve të rëndësishëm në kuadër të përgatitjes së një strategjie kombëtare të punësimit me ekspertiza apo projekte pilot për të bërë ndërlidhjen mes kërkesave të biznesit dhe atë që tregu ofron. Kjo strategji do dojë kohën e saj dhe shpreson që dhomat e tregtisë të jenë aktorë që të kenë peshë në këtë drejtim dhe meqenëse po rishikohet edhe ligji për dhomat të konsiderohet një ndryshim sikurse u bë me Dhomën e Zejtarisë që shihet që po jep rezultate të mira.

Z. Arben Shkodra, Unioni i Prodhuesve Shqiptarë, shprehu dakordësinë me gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e analizës, por u shpreh se vendi ende nuk ka arritur mesin e krizës së punësimit. Kriza sapo ka filluar. Unioni ka kryer një sondazh me industrinë prodhuese ku mbi 70% e saj rezultojnë me nevoja emergjente për shkak të rritjes së kapacitetit me më shumë se 50%. Kemi nevojë për të krijuar një mjedis të nevojshëm për punonjësit nga jashtë, duke konsideruar edhe aspektin social të kësaj politike pasi ato do jenë pjesë e shoqërisë sonë. Sugjerohet të organizohen tryeza të veçanta teknike pas kësaj mbledhje, mbi arsimin e lartë, profesional,

punësimin të të huajve dhe aftësimin e riaftësimin. Kjo duhet të ishte buxhetuar dhe ndoshta nuk është akoma vonë.

Ministër Delina Ibrahimaj, MFE, u shpreh se janë ngritur komitete sektoriale mbi IT, turizmin dhe do vijohet me komitete të tjera sektoriale, pasi ka në vijimësi problematika sikurse në rastin e sektorit të pastërçerive. Qeveria me ligjet, strategjitë, incentivat që ndërmerr, orienton edhe drejt automatizimit të proceseve nga biznesi. Sigurisht që nuk është e thjeshtë pasi bizneset kanë problemet e tyre. Çështja e pagës që është më e ulëta në rajon është një tjetër problematikë dhe arsye pse individët duan të largohen, pasi paga duhet të jetë konkurruese. KI, Sekretariati, Zv/Ministrja Olta Manjani, Drejtori i AKPA-s, Drejtori i Inspektoratit të Punës do marrin përsipër që të vijojë ky diskutim, të bëhet një axhendë e veçantë që një herë në muaj aktorët të ulen të diskutojnë si në nivel ministror ashtu edhe në atë teknik pasi ka mjaft problematika që duhen diskutuar për zgjidhje.

Mbyllja e mbledhjes

Në përfundimin të të gjitha komenteve, Ministrja Ibrahimaj falenderoi pjesëmarrësit për dialogun dhe e konsideroi mbledhjen të mbyllur.

Lista e pjesëmarrjes

Përfaqësues të qeverisë

1. Znj. Delina Ibrahimaj, Kryetare e Këshillit të Investimeve/Ministre e Financave dhe Ekonomisë

Përfaqësues të biznesit

1. Znj. Albana Laknori, Sekretare e Përgjithshme, deleguar nga z. Nikolin Jaka, Kryetar, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë
2. Znj. Ines Muçostepa, Kryetare, Unionit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë (UCCIAL)
3. Znj. Elisabeta Katiaj, Nënkryetare, Dhoma Shqiptare e Biznesit të Diasporës
4. Znj. Valbona Begolli, Nënkryetare, Dhoma Ekonomike e Gruas
5. Z. Arben Shkodra, Sekretar i Përgjithshëm, Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë
6. Znj. Fiona Kuqi, Menaxhere për Politikën dhe Avokimin, deleguar nga z. Enio Jaço, Presidenti i AmCham Albania
7. Z. Dritan Nako, Menaxher i Çështjeve Ligjore & Marrëdhënieve me Jashtë, Antea Cement (*ad-hoc*)
8. Z. Edvin Prenci, Kryetar, Proeksport Albania (*ad-hoc*)

Partnerë ndërkombëtarë

1. Z. Emanuel Salinas, Menaxheri i Zyrës së Banka Botërore në Tiranë
2. Znj. Ekaterina Solovova, Drejtore e Zyrës së BERZH-it në Shqipëri
3. Znj. Ledia Muço, Këshilltare për Çështjet Ekonomike, deleguar nga z. Hubert Perr, Shef i Bashkëpunimit, Delegacioni i BE-së

Nuk morën pjesë:

1. Znj. Edona Bilali, Ministër i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes
2. Znj. Natasha Ahmetaj, Zëvendës Guvernatore e Bankës së Shqipërisë
3. Z. Sokol Nano, CEO, AIDA
4. Z. Bilal Kara, Kryetar, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Shqiptari – Turqi (ATTSO)
5. Znj. Laura Qorlaze, Përfaqësuese e Zyrës së IFC në Shqipëri

Të ftuar të tjerë të veçantë nga ana e Qeverisë:

1. Znj. Olta Manjani, Zv/Ministër, MFE
2. Z. Klevis Hysa, Drejtor i Përgjithshëm, AKPA
3. Z. Eljo Muçaj, Kryeinspektor, Inspektoriati Shtetëror i Punës
4. Znj. Erblina Shehu, Keshilltar i Ministrit

Te ftuar të tjerë:

1. Z. Alessandro D'Oria, President, FIAA
2. Z. Martin Serreqi, Zv/Dekan për Sipërmarrjen dhe Marrëdhënien me Publikun, FEUT
3. Znj. Donada Rata, Koordinatore Projekti, Rrjeti i Profesionistëve të Rinj
4. Z. Luan Bregasi, President, Business Albania
5. Z. Gëzim Peshkopia, President, Shoqata e Bukës, Brumërave dhe Pastiçerive

6. Z. Elvis Ponari, Kryetar, Shoqata e Siguruesve të Jetës, Pensioneve dhe Fondeve të Investimit
7. Z. Reinaldo Pipiria, Kryetar, Shoqata Shqiptare e Pasurive të Paluajtshme (NAREA)
8. Znj. Katina Gjoni, Shkolla Profesionale “Antoni Athanas”
9. Znj. Ardita Seknaj, Sekretare e Përgjithshme, ICC Albania
10. Prof. Alba Kruja, Pedagoge, Universiteti Epoka
11. Z. Artan Gjergji, Sekretar i Përgjithshëm, Shoqata Shqiptare e Tregtisë Elektronike (AECA)
12. Z. Dritan Mezini, Kryetar, AITA
13. Z. Ardian Haçkaj, Drejtor, Instituti, Bashkëpunimit dhe Zhvillimit (CDI)
14. Znj. Erifili Berberi, Drejtore Ekzekutive, Hellenic Business Association of Albania
15. Z. Shkëlzen Marku, Ekspert